
 <b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosovo</b>	<b>Zyra e Personelit</b> <b>Kancelarija za Osoblje</b>		 <b>Komuna e Istogut</b> <b>Opština Istok</b>
	<b>02 Nr.03/19</b>	<b>Datë:</b> <b>09.01.2019</b>	

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil , Komuna e Istogut shpall :

## K O N K U R S

### Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

**Vendi i punës :** Zyrtar/e për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve Kapitale  
**Drejtoria:** Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim  
**Lloji i pozitës:** Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, kohëzgjatja 6 muaj  
**Numri i referencës:** 02Nr.03 /19  
**Numri i ekzekutuesve:** 1 (një)  
**Orari i plotë:** 40 orë në javë  
**Paga:** 400 euro

#### **Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Bënë mbikëqyrjen e kryerjes së punëve në të gjitha fazat e punës lidhur me realizimin e projekteve për investime kapitale;
- Përgatitë planin për ndërtimin dhe rindërtimin e rrugëve dhe mbikëqyrë ecurinë e zhvillimit të punëve;
- Kujdeset për planifikim dhe mbikëqyrjen e objekteve ndërtimore;
- Merr pjesë në komisionin për kontrollimin teknik të projekteve në lëmin përkatëse;
- Ndhmon në hartimin e projekt-rregulloreve që i përket kësaj lamie;
- Pranon kërkesat e qytetarëve dhe kujdeset për zhvillimin e tyre në përputhje me dispozitat ligjore;
- Harton raporte periodike dhe përfundimtare për investime kapitale në lëmit përkatëse;
- Kujdeset për përcjelljen e situacioneve të projekteve, mbikëqyrjen e realizimit të projekteve të kësaj fushe si dhe përgatitë raportet përfundimtare për projektet e realizuara, si dhe punë tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi.

#### **Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

Të drejtë konkurrimi në këtë pozitë kane shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Dokumentet:**

- Dëshmi të kualifikimi shkollor: diploma e Fakultetit Teknik, drejtimi i arkitekturës.
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dy rekomandime;
- Dokument identifikimi;
- Certifikata e lindjes apo ekstrakti;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;

**Afati i Konkurimit:** Konkursi është i hapur tetë (8) ditë kalendarike nga data e publikimit, procedur e shpejtuar.

Data e shpalljes së konkursit: 09.01.2019 deri më 16.01.2019

**Paraqitja e kërkesave :** Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

*"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "*

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen

**Menaxheri i Personelit**  
**Fatmir Bytyçi**

